

Möllers, Judith; Arapi-Gjini, Arjola; Xhema, Sherif; Herzfeld, Thomas

Research Report

Eksodi Kosovar: Si një shtet i ri në ndërtim po humbet shtetasit e tij

IAMO Policy Brief, No. 24a

Provided in Cooperation with:

Leibniz Institute of Agricultural Development in Transition Economies (IAMO), Halle (Saale)

Suggested Citation: Möllers, Judith; Arapi-Gjini, Arjola; Xhema, Sherif; Herzfeld, Thomas (2015) : Eksodi Kosovar: Si një shtet i ri në ndërtim po humbet shtetasit e tij, IAMO Policy Brief, No. 24a, ISBN 978-3-95992-004-9, Leibniz Institute of Agricultural Development in Transition Economies (IAMO), Halle (Saale), <https://nbn-resolving.de/urn:nbn:de:gbv:3:2-54982>

This Version is available at:

<https://hdl.handle.net/10419/112782>

Standard-Nutzungsbedingungen:

Die Dokumente auf EconStor dürfen zu eigenen wissenschaftlichen Zwecken und zum Privatgebrauch gespeichert und kopiert werden.

Sie dürfen die Dokumente nicht für öffentliche oder kommerzielle Zwecke vervielfältigen, öffentlich ausstellen, öffentlich zugänglich machen, vertreiben oder anderweitig nutzen.

Sofern die Verfasser die Dokumente unter Open-Content-Lizenzen (insbesondere CC-Lizenzen) zur Verfügung gestellt haben sollten, gelten abweichend von diesen Nutzungsbedingungen die in der dort genannten Lizenz gewährten Nutzungsrechte.

Terms of use:

Documents in EconStor may be saved and copied for your personal and scholarly purposes.

You are not to copy documents for public or commercial purposes, to exhibit the documents publicly, to make them publicly available on the internet, or to distribute or otherwise use the documents in public.

If the documents have been made available under an Open Content Licence (especially Creative Commons Licences), you may exercise further usage rights as specified in the indicated licence.

Botimi Nr. 24
Qershor 2015

Judith Möllers
Arjola Arapi-Gjini
Sherif Xhema
Thomas Herzfeld

Eksodi Kosovar: Si një shtet i ri në ndërtim po humbet shtetasit e tij

Një eksod masiv i qytetarëve të Kosovës ndodhi në dimrin e vitit 2014/2015, duke ngritur pyetje urgjente mbi arsyet e tij dhe implikimet e mundëshme për Kosovën dhe vendet e destinacionit. Kjo analizë e shkurtër politike jep një përshkrim përmbajtësor të shkaqeve kyçe të migracionit dhe një vështrim mbi veçantitë e fenomenit. Ne arrijmë në konkluzionin që eksodi është rezultat i një shteti të ri në ndërtim, i cili nuk mban dot më entuziasmin dhe shpresën e qytetarëve e ta kthejë atë në zhvillim të qëndrueshëm. Në të kundërt, humbja e shpresave dhe perspektivës, si dhe zhgënjimi i akumuluar mbi klasën aktuale politike, nepotizmin dhe korrupsionin po largojnë tashmë dhe klasën e mesme. Shtrirja dhe koha e kësaj vale migracioni është e lidhur ngushtë me lehtësimin e kushteve të udhëtimit dhe thashethemeve nxitëse që krijuan një efekt të ortekut. Ne argumentojmë që vendet e BE-së duhet të reagojnë me durim dhe kujdes në trajtimin e migrantëve që vijnë nga Kosova. Ndryshime në regjimin e azilit dhe atë të vizave janë të rekomandueshme, por gjetja e kohës së duhur për marrjen e masave është shumë e rëndësishme. Së fundmi, për të parandaluar një thellim të krizës dhe trazira të mëtejshme në Kosovë, lehtësimi i mundësive për migracion të përkohshëm ligjor është i nevojshëm. Brenda Kosovës, vetëm thyerja e strukturave aktuale dhe krijimi i institucioneve efikente dhe modeleve sociale funksionuese do ti lejoj vendit të kapërcej këtë ngecje ekonomike.

Evropa aktualisht po kalon një krizë të thellë migracioni. Një numër i paprecedent migratësh është drejtuar drejt BE-së, duke kulminuar në fillim të 2015-tës. Ndërsa fokusi i mediave është drejtuar në tragjeditë e anijeve në Mesdhe, një eksod masiv ka ndodhur prej Kosovës që ngre pyetje urgjente mbi shkakun e tij dhe implikimet e mundëshme si për Kosovën, ashtu dhe për vendet e destinacionit.

Migrimi jashtë ka një traditë të gjatë në Kosovë, por lëshimi i vendit nuk ka qënë kurrë një perspektivë e mirëpritur. Në veçanti, komunitetet rurale dërgonin emigrantë kur baza tradicionale e jetesës së tyre, ferma, nuk mund të siguronte jetesën e familjes së madhe tradicionale. Shtypja dhe lufta e Kosovës çuan në një numër të madhë refugjatësh në periudhën midis viteve 1980–1999. Me mbarimin e luftës në 1999, u duk sikur koha e migracionit masiv erdhi drejt fundit. Shumë Kosovarë u kthyen në vendin e tyre me shpresa për një të ardhme më të mirë. Në të njëjtën kohë, dyert e

migracionit u mbyllën kur mes të tjerash, Gjermania, aty ku shumë refugjatë Kosovarë jetonin, e përfundoi politikën bujare të tolerimit¹. Pamvarësisht kësaj, migracioni jashtë është rritur në vitet në vazhdim. Vala e migracionit që filloi në vjeshtë të 2014-tës dhe kulminoi në fillimet e 2015-tës konsiderohet ekstreme në këtë lëvizje të re. Më shumë se 100,000 njerëz mund të kenë kaluar ilegalisht kufijtë e BE-së në një periudhë kohe shumë të shkurtër. Vetëm në Gjermani, më shumë se 20,000 Kosovarë arritën në tre muajt e parë të 2015-tës (krahasuar me rreth 1,400 të ardhur në të njëjtën periudhë në 2014).

¹ Tolerimi ('Duldung') do të thotë që për momentin personi nuk mund të detyrohet të largohet nga vendi. Arsyet për dhënie të një lejeje qëndrimi nën politikën e tolerimit, mund të jenë p.sh. sëmundje, apo situatë lufte në vendin e lindjes. Shumë njerëz nga Kosova dhe Serbia, qëndruan në Gjermani me leje të tilla për shumë vjet; megjithatë statusi i tyre mbeti i pasigurt pasi këto leje lëshoheshin vetëm për një kohë të shkurtër.



Burimi: Pfohlmann/toonpool.com

Objektivi dhe përqsja

Kjo analizë e shkurtër politike paraqet një përshkrim cilësor të shkaqeve kyçe të migracionit dhe një vështrim mbi veçantitë e fenomenit. Ne kryesisht i referohemi shtatë intervistave të kryera me ekspertë dhe trembëdhjetë intervistave cilësore që mbulojnë shakqet e migracionit dhe perceptimin individual të migrantëve Kosovarë që aplikuan për azil në Karlsruhe të Gjermanisë gjatë valës së fundit të migracionit. Ky hulumtim u krye prej Marsit deri në Maj të 2015-tës dhe gjithashtu përfshin dhe raporte prej mediave.

Çfarë e shtyn këtë eksod?

Ne identifikojmë tre faktorë kryesorë që e shtyn këtë valë migracioni. E para dhe më e rëndësishmja është një nivel i lartë i zhgënjimit me politikën kosovare. E dyta qëndron vuajtja e vazhdueshme ekonomike dhe mungesa e perspektivës. E treta konsiston në një kombinim faktorësh lehtësues që sollën këtë valë migracioni.

'Janë politikanët që na detyrojnë me e lëshu vendin. Politikanët duhet me u kujdes për punë e shtetit, por çfarë bëjnë ata? Ata kujdesen vetëm për familjet e tyre dhe u japin punë pjestarëve të familjes që nuk kanë as diploma.'

Migrant i intervistuar në Karlsruhe, 02/2015

Zhvillimet e fundit politike, dhe në veçanti krijimi i koalicionit qeverisës aktual, i cili shihet si një tjetër vërtetim i egzistencës së politikanëve të korruptuar që do të bashkëpunonin me armikun e tyre më të keq për të qëndruar në pushtet, kanë shkaktuar një ndjenjë të madhe zhgënjimi që mund të shihet si shkëndija që e nisi këtë valë migracion. Migrantët fajësojnë politikanët për një treg pune tashmë tejet të politizuar, për korrupsion dhe mungesë të ligjit. Këta migrantë ndjejnë që e ardhmja iu është rrëmbyer nga politikanët dhe nga më të fuqishmit mes tyre. Për më tepër, ata ndihen të gënjer prej

vendeve të BE-së, misioni ligjvënës i të cilave, EU-LEX, akuzohet për korrupsion dhe për mbrojtje ndaj figurave të larta qeveritare. Ka në fakt prova të mjaftueshme për gjëndjen e pasigurt të vendit dhe për qeverisjen e dobët. Cappusela (2015), dëshmon sesi Treguesi i Qeverisjes i Bankës Botërore për Kosovën, ndryshe nga shumë vende të tjera të Ballkanit, nuk ka treguar asnjë progres gjatë viteve të fundit.

'Ne jemi një familje prej 8 vetash dhe askush nuk punon. Si do të mund të jetojmë? [...] Ti çfarë do të bëje po të shihje familjen tënde pa bukë?'

Migrant i intervistuar në Karlsruhe, 02/2015

'Njerëzit këtu më mirë vdesin sesa të kthehen në Kosovë. Për 15 vjet kemi dëgjuar 'prisni, prisni, prisni', dhe ne kemi pritur, por asgjë nuk ka ndryshuar.'

Migrant i intervistuar në Karlsruhe, 02/2015

Një e treta e popullsisë Kosovare jeton në varfëri, dhe ky është një faktor shtytës shumë i fuqishëm. Megjithatë, statistikatat nuk mbështesin nocionin që situata ekonomike është vështirësuar aq sa të mund të shpjegoj mjaftueshëm këtë valë migracioni. GDP-ja e Kosovës u rrit me 5 përqind në 2014, dhe rrogat gjithashtu janë ngritur. Intervistat tona gjithashtu konfirmojnë se shumica e njerëzve që janë larguar nuk u larguan sepse ishim të papunë e të varfër, por sepse kishin humbur shpresën se gjërat do të ndryshonin për më mirë. Një nga ekspertët që ne intervistuar, Alban Hashani, e quan këtë një 'pesimizëm kolektiv' të një populli të cilit po i shteron durimi me këtë shtet të ri në ndërtim dhe ndihet që nuk ka asgjë për të humbur.

'Ne Kosovarët besojmë shumë dhe shpresojmë akoma më shumë.'

Expert E. Gjokaj

Një kombinim faktorësh lehtësues kontribuan gjithashtu në këtë eksod. Edhe pse shumica e migrantëve nuk i përmendin ndër arsyet kryesore të largimit, këta faktorë lehtësues ndihmojnë në shpjegimin e përmasave dhe të kohës së këtij eksodi. Premtime jo reale u shpërndanë në formën e thashethemeve përmes medias dhe rrjeteve

personale nëpër Kosovë. Disa ekspertë sugjerojnë se ata të cilët përfituan drejtpërsëdrejti prej këtij eksodi, me një fjalë trafikantët dhe bashkëpunëtorët e tyre, kanë kontribuar në shpërndarjen e këtij informacioni incentivues. Një shembull ishin fjalët e përhapura në rajonin e Ferizajit se Gjermania do t'u njihte automatikisht të drejtën e azilit të gjithë migrantëve që mbërrinin gjatë muajit Shkurt 2015.

Kushtet më lehtësuese udhëtimi e kanë ulur në mënyrë të konsiderueshme koston e migracionit. Në të vërtetë, shumë migrant kanë paguar vetëm disa qinda Euro për person për tu larguar, rreth 10–20 përqind më pak sesa vlera standarde e mëparshme e trafikimit. Kufiri mes Serbisë dhe Hungarisë është relativisht i kalueshëm dhe ka kohë që përdoret nga migrantët ilegalë për të hyrë në BE, por dy ndryshime kryesore kanë mundësuar këtë migracion: Hungaria nuk i ndalon më migrantët për shkak të një ndryshimi në ligjin e azilit për ta njeësuar me legjislacionin e BE-së. Për rrjedhojë, që prej 2013-tës migrantët mund të largohen prej Hungarisë lehtësisht për në vendet e tyre të destinacionit. Së dyti, udhëtimi pa pengesa përmes Serbisë është tashmë i mundshëm që prej vjeshtës së 2014-tës kur hyrja pa viza për në territorin e Serbisë u bë e mundshme.

Së fundmi, një efekt orteku ndërtoi këtë valë të fundit të migracionit. Ndjenja e të mos dashurit të qëndruarit në një vend kur gjithë të tjerët largohen, së bashku me thashethemet që rritën shumë shpresat, si dhe mungesa e sinjaleve të qarta nga vendet e destinacionit që dëbim i menjëhershëm do të ndodhë, të gjitha këto kontribuan së bashku në nxitjen e këtij eksodi.

Kush janë migrantët?

Migrantët janë në përgjithësi njerëz nga klasa e mesme e ulët, të varfër por jo nga shtresat më të varfra. Ne vlerësojmë që rreth 60 përqind e migrantëve të ardhur kanë mbaruar të paktën edukimin e mesëm, dhe duket ta kenë lënë Kosovën në mënyrë spontane, pa më shumë se pak ditë midis marrjes së vendimit për tu larguar dhe largimit eventual të tyre. Shumë prej këyre migrantëve janë të painformuar dhe naiv në lidhje me pritshmëritë në vendet e destinacionit – kjo pamvarësisht faktit se ka një numër të konsiderueshëm njerëzish me eksperiencë migracioni në BE apo dhe me njohuri paraprake të gjuhës Gjermane. Këta të fundit e kanë lënë Gjermaninë vullnetarisht pas përfundimit të luftës; tashmë kthehen sërish në Gjermani të zhgënjyer e më shpresën për t'iu rikthyer jetës së tyre të mëparshme. Ka mes tyre dhe një grup të dallueshëm të rinjsh që mund të quhen një 'brez i humbur'; dikur ata ndiqnin shkollën në Gjermani dhe tani duan të rikthehen pasi asnjëherë nuk mundën të integroheshin plotësisht në shoqërinë Kosovare.

Pjesa më e madhe e migrantëve në Gjermani i ngjason prototipit të migrantit – djem të rinj të pamartuar, me dëshirë dhe kapacitet për të punuar. Këta djem të rinj janë të dëshpëruar për një punë të sigurtë e të paguar, të cilën nuk mund ta gjejnë në

Kosovë. Një fenomen i ri është dhe numri i konsiderueshëm i njerëzve të cilët janë larguar në grup ose me familje. Jo të gjithë janë të varfër, por i kthejnë kurrizin një jete pa perspektivë. Eksperti Beqe Cufaj e vlerëson migrimin familjar të përbërë gati 20 përqind të numrit të migrantëve; eksperti Alban Hashani konsideron që gati 50 përqind e migrantëve kanë udhëtuar në grupe me disa pjesëtarë të familjeve. Së fundmi, ka dhe një grup të vogël rreth 10 përqind që përbëhet nga njerëz shumë të varfër ose njerëz që i përkasin shtresave më të dobëta. Shpesh këta janë të moshuar ose njerëz me probleme shëndetësore të cilët shpresojnë të marrin një trajtim të duhur mjekësor dhe asistencë sociale.

Implikime

Në përmbledhje, mungesa e perspektivave të qarta dhe një zhgënjim i akumuluar për klasën politike që përdor publikun për tu pasuruar, korrupsioni galopant, nepotismi dhe papunësia po largojnë tashmë dhe klasën e mesme e familje të tëra nga Kosova. Vala e fundit e migracionit mund të shihet si rezultat i një shteti të ri në ndërtim i cili dështoi në mbajtjen e entuziasmit dhe të shpresës së këtij populli të ri dhe ta kthente atë energji në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e politik.

Pakënaqësia me sistemin politik aktual është themelore në shpjegimin e këtij eksodi të fundit. Duke qënë se si migrantët ashtu dhe ekspertët janë shprehur që alternativa e të larguarit nga vendi do të ishin protesta të dhunshme dhe trazira sociale, ne e interpretojmë këtë eksod si një revoltë ndaj sistemit politik. Kjo mbart rrezikun e një krize me rezultate ende të panjohura mirë, sidomos nëse këta migrantë do të ktheheshin menjëherë.

Brenda Kosovës, ky largim i njerëzve mund të lehtësojë në kohën afatshkurtër tensionet në tregun e punës. Nëse ka sjellje remitancash, migracioni mund gjithashtu të përmirësojë jetesën e familjeve të varfëra. Megjithatë, nëse këta migrantë kthehen përpara se ata arrijnë të mbulojnë shpenzimet e migracionit të tyre, situata mund të përkeqësohet. Humbja e njerëzve gjatë dimrit të 2014/2015 mund të çojë në humbje të gati 10 përqind të fuqisë punëtore të Kosovës. Përfundimisht, ky eksod paraqet një rrezik të konsiderueshëm për qëndrueshmërinë e këtij shteti të ri ku të rinjtë tashmë kanë humbur shpresat e tyre dhe durimin, dhe një masë e madhe njerëzish të shkolluar prej klasave të mesme po largohen.

Rekomandime

Korrupsioni është i lidhur me migracionin, ai e mundëson migracionin dhe pengon kthimin e njerëzve në vendin e tyre (Carling et al. 2015). Kjo lidhje meriton vëmendje të veçantë në rastin e Kosovës ku dhe thirrja për politika kundra korrupsionit mbetet manifest. E megjithatë, zgjidhjet sado gjithëpërfshirëse e të targetura të jenë, duan kohë. Ndërkohë, vendet e BE-së duhet të fillojnë të mësohen me

idenë që shtetasit Kosovar do të vazhdojnë të hyjnë në BE – pamvarësisht nëse janë apo jo të mirëpritur.

Rifitimi i besueshmërisë, qeverisje më e mirë dhe reforma anti-korrupsion

Klasa politike në Kosovë ka shkaktuar një zhgënjim shumë të madh që po i shtyn njerëzit të largohen. Për ta ndryshuar këtë, gatishmëria për ndryshim në Kosovë është shumë e nevojshme. Kosova duhet të bëjë të pamundurën, që do të thotë, duhet të ndahet me të shkuarën e saj të strukturave klano-re, tregjeve të politizuara të punës, dhe rrethin e korrupsionit. Vetëm kjo do ti lejojë vendit të rifitojë kredibilitet, të përfundojë ngecjen ekonomike dhe të zvogëlojë shkallën e migracionit. Si hap i parë, Kosova duhet tu rikthejë qytetarëve të saj ndjenjën e sigurisë (dhe atë të drejtësisë) dhe, veçanërisht duhet të transformojë tregun gri të punës në një treg që bazohet në kontrata të detyrueshme dhe që ofron akses të drejtë në punë si dhe një sistem sigurimi social. Nga ana tjetër, vendet e BE-së duhet të rivendosin besueshmërinë e tyre. Kosova është një projekt ndërtimi dhe demokratizimi i një shteti i ndërmarrë nga vendet Perëndimore që rrezikon të shkojë drejt falimentimit. Është shumë e rëndësishme të kuptohet se çfarë çoi në këtë rrjedhje të gjakut, dhe të sigurohet që politikat e ardhshme të BE-së të jenë më të besueshme dhe efektive në fuqizimin e institucioneve.

Ka prova të mjaftueshme që tregojnë se qeveritë mund të kontribuojnë fuqishëm në zhvillimin ekonomik të vendeve duke ngritur institucione që ulin pasigurinë e investitorëve dhe kreditorëve, veçanërisht duke luftuar korrupsionin dhe ndërtuar një burokraci eficiente (p.sh. Koester dhe Forstner 2014). Ne propozojmë krijimin e një administrate shtetërore të re të de-politizuar përmes së cilës mund të implementohen masa të fuqishme anti-korrupsion. Reformat e sukseshme në Gjeorgji mundet të shërbejnë si një udhërrëfues konkret për Kosovën (Banka Botërore, 2012). Ndërsa mbështetja e përgjithshme e popullatës është aty, një pushtet ekzekutiv i besueshëm me një vizion të qartë kundra korrupsionit është i domosdoshëm për të drejtuar një luftë frontale me tolerancë zero ndaj korrupsionit. Masat e domosdoshme përfshijnë rinovimin dhe zvogëlimin e sektorit shtetëror në të gjitha nivelet, si dhe pagesa të përshatshme për të bërë një punë të ndershme.

Rimendimi i rregullave për vizat në BE

Rregullat për vizat dhe ligjet e azilit kanë luajtur një rol të rëndësishëm në lehtësimin dhe nxitjen e këtij migracioni. Megjithatë, kur BE-ja mendon për masat që duhen marrë, faktori kohë duhet konsideruar me shumë vëmendje. Shpejtimi i procesimit të kërkesave për azil është padiskutim i nevojshëm dhe mund të çojë në një ulje të kërkesave për azil. Por, dëbimi i menjëhershëm mbart në vetvete rrezikun e krijimit të tensioneve të reja në Kosovë (për rrjedhojë dhe një fluks të ri migracioni). Një zgjidhje e arsyeshme mund të jetë dhënia e lejeve të përko-hshme të punës migrantëve të cilëve u është refuzuar kërkesa për azil si pjesë e një politike kthimi

graduale, duke shmangur kështu dhe kundërshtimin e vendimeve dhe procedurat e gjata e të kushtueshme gjyqësore. Masa të tilla duhet të jenë të limituara në kohë dhe duhet të aplikohen vetëm për ata që tashmë janë në procesin e aplikimit për azil, për të mos krijuar kështu stimul për një valë të re migracioni.

Mundësi migracioni legal në vendet e BE-së

Azili nuk është një rrugë e dëshirueshme apo e pranueshme migracioni për shumicën e shtetasve Kosovarë. Për këtë arsye, është e nevojshme të mendohet për mundësi alternative migracioni legal. Kosovarët kanë shumë nevojë për mundësi punësimi jashtë vendit sepse edhe në skenarin më optimist shumica e të rinjve nuk do të mund të punësohen në afatin e mesëm në Kosovë. Kriza sociale që do të rezultojë prej kësaj, do të kontribuojë në dështimin e projektit të ndërtimit të shtetit, një skenar që nuk është në interesin e BE-së. Për Gjermaninë, marrja e përgjegjësisë, veçanërisht për këtë 'brez të humbur' të rinjsh që u rritën në Gjermani, duhet të jetë një çështje e natyrshme. Prospekti më i vogël i mundësisë për migracion legal në të ardhmen, ose edhe marrja pjesë në programet e vizave të BE-së, sipas mendimit tonë, do të ndihmojë në uljen e eksodit ilegal². Përrjashtimi i Kosovës nga regjimi i lëvizjes pa viza që tashmë është i mundur për të gjitha vendet fqinje (p.sh. Shqipëria, Maqedonia), ngjall një ndjenjë izolimi dhe abandonimi, dhe vetëm rrit dëshirën dhe ngutën për tu larguar. Sigurisht që një politikë e re vizash duhet të harmonizohet me futjen në kohë të masave që do të ndalonin abuzimin e sistemit të azilit, si për shembull preçedura të shpejta të procesimit të kërkesave për azil, shpërdarje e kujdeshme e ndihmës financiare për aplikuesit, dhe fushata të planifikuara informuese.

'Unë nuk dëshiroj asgjë prej shtetit [Gjerman]. Gjithçka dua është vetëm një leje punësimi. Nëse arrij të punoj, mund me gjetë qetësi.'
Migrant i intervistuar në Karlsruhe, 02/2015

Punësimi ligjor i përkohshëm, sezonal apo cirkular paraqesin mundësi të përshtatshme për të hyrë ligjërisht në tregjet e punës pa rrezikshërinë e rrjedhjes së trurit. Pamvarësisht debateve mbi migracionin e përkohshëm dhe atë cirkular si një 'zgjidhje e trefishtë' për menaxhimin e migracionit (që i sjell dobi vendeve të destinacionit, migrantëve dhe vendeve të origjinës), këto forma migracioni duken të përshtatshme duke patur parasysh modelin tradicional të migracionit prej Kosovës. Familjet e varfëra do të përfitojnë prej remitançave, dhe tregu i punës do të lehtësohet duke lejuar kështu kryerjen e reformave thelbësore. Për shoqëritë që i presin këta migrantë është e rëndësishme të kuptohet që shtetasit Kosovarë duan të kenë qasje në sistemin ekonomik dhe social të BE-së vetëm përmes punësimit. Në këtë aspekt, mundësitë për udhëtim dhe migracion legal ofrojnë zgjidhjen më të mirë.

² Mendimi se vendosja e barrierave shërben për ta rritur migracionin ilegal dhe i vë shtresat më të dobëta në një rrezik të lartë shfrytëzimi mbështetët dhe nga ekspertët e intervistuar të Organizatës Ndërkombëtare për Migracion (ONM).

Informacion i mëtejshëm

Publikime dhe Literatura

Forstner, Bernhard; Koester, Ulrich (2014). EU investment support for small and medium-sized enterprises in southern Europe: to be recommended?

IAMO Policy Brief No. 17, Halle (Saale). http://www.iamo.de/fileadmin/documents/IAMOPolicy-Brief17_en.pdf

Carling, J., E. Paasche, and M. Siegel (2015). Finding connections: The Nexus between Migration and Corruption. <http://www.migrationpolicy.org/article/finding-connections-nexus-between-migration-and-corruption>

Capussela, A. L. (2015). State-Building in Kosovo. Democracy, Corruption and the EU in the Balkans. London and New York: I. B. Tauris

World Bank (2012). Fighting corruption in public services. Chronicling Georgia's reforms. <http://elibrary.worldbank.org/doi/book/10.1596/978-0-8213-9475-5>

Lista e ekspertëve të intervistuar: Beqe Cufaj, Publicist Kosovar i vendosur në Gjermani, Gazetar dhe Shkrimtar; Jorge Baca-Vaughan, Shef i Misionit, Zyra e Organizatës Ndërkombëtare për Migracion (ONM) Pristinë; Magdalena Majkowska-Tomkin, Shefe e Misionit, Zyra e Organizatës Ndërkombëtare për Migracion (ONM) Budapest; Besa Shahini, Analiste e lartë, Iniciativa Evropiane për Stabilitet; Ekrem Gjokaj, Drejtor i Departamentit për Analiza Ekonomike dhe Statistikat Bujqësore, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Pristinë; Alban Hashani, Drejtor i Hulumtimeve, Riinvest Instituti për Hulumtime Zhvillimore, Pristinë; Agron Demi, Drejtor Ekzekutiv, Instituti për Studime të Avancuara (GAP).

Kontakt

Dr. Judith Möllers
moellers@iamo.de
Tel.: +49 345 2928-245
Faks: +49 345 2928-199

Leibniz Institute of Agricultural Development in Transition Economies (IAMO)
Theodor-Lieser-Str. 2
06120 Halle (Saale)
Gjermani/Germany
www.iamo.de/en

ISSN 2364-8902
ISBN 978-3-95992-004-9

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë përgjegjësia e vetme e autorëve.

IAMO

Leibniz Institute of Agricultural Development in Transition Economies (IAMO)

Leibniz Institute of Agricultural Development in Transition Economies (Institut Leibniz për Zhvillim Bujqësor në Ekonomitë në Tranzicion) (IAMO) analizon proceset ekonomike, sociale edhe politike të ndryshimeve në sektorin e bujqësisë dhe atë të ushqimit, si dhe në zonat rurale. Fokusi gjeografik përfshin Bashkimin Evropian (BE) në zgjerim, rajonet në tranzicion në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore, si dhe në Azinë Qendrore dhe Lindore. IAMO kontribuon drejt përmirësimit të kuptimit të ndryshimeve institucionale, strukturale

dhe teknologjike. Për më tepër, IAMO studion impaktet në sektorin e bujqësisë dhe atë të ushqimit si dhe kushtet e jetesës së popullsisë në zonat rurale. Rezultatet e punës tonë përdoren për të nxjerrë dhe analizuar strategjitë dhe opsionet për sipërmarrjet, tregjet bujqësore dhe bërjen e politikave të caktuara. Që prej themelimit në vitin 1994, IAMO ka qënë pjesë e Shoqatës Leibniz, një komunitet institutesh të pavarura shkencore Gjermane.